

Fëshfërimat e zemrës tek foshnjat

Informacion për prindërit

Urime për lindjen e foshnjës tuaj. Gjatë ditëve të para të jetës të gjitha foshnjave u bëhet një kontroll i zemrës si pjesë e ekzaminimi të të sapolindurit. Kjo është një mënyrë për të kuptuar çdo problem herët për t'u siguruar që foshnjës juaj t'i bëhen analizat dhe t'i jepet kujdesi i duhur.

Kjo fletë u jep përgjigje pyetjeve të zakonshme që mund të keni nëse foshnja juaj ka një fëshfërimë të zemrës. E dimë se kjo mund t'ju shqetësojë kur e dëgjoni, por fëshfërimat janë relativisht të zakonshme tek të sapolindurit dhe nuk tregojnë medoemos një problem të zemrës.

Nëse dëshironi informacione të mëtejshme ose keni ndonjë shqetësim të veçantë, ju lutemi mos ngurroni të pyesni një mjek ose mami.

Në të gjitha rastet, një mjek do t'ju shpjegojë se çfarë do të thotë nëse foshnja juaj ka një fëshfërimë në zemër dhe do i përgjigjet çdo pyetjeje që mund të keni.

Çfarë është fëshfërima e zemrës?

Fëshfërima e zemrës është një zhurmë e fortë që dëgjohet nëpërmjet një stetoskopi e cila shkaktohet nga gjaku që kalon në zemër. Pavarësisht se kjo shpesh është një dukuri normale, të cilat quhen "fëshfërima të pafajshme", kjo mund të jetë një shenjë e një problemi me zemrën.

Fëshfërimat janë të zakonshme tek foshnjat e porsalindura pasi normalisht në zemër ndodhin ndryshime pas lindjes së foshnjës. Ato priren të

zhduken ndërsa fëmija rritet. Në disa raste, një fëshfërimë mund të shkaktohet nga gjaku që kalon një vrimë në zemër, nga një valvulë e zemrës e cila është tepër e ngushtë ose nëse ka rrjedhje në valvulën e zemrës.

Çfarë ndodh tani?

Nëse tek foshnja juaj është zbuluar se ka një fëshfërimë pas më pak se 24 orëve të jetës, ata do të ekzaminohen sërish për të parë nëse fëshfërima është larguar vetë, rast në të cilin në përgjithësi nuk nevojiten më analiza të tjera.

Në rast se një fëshfërimë është e pranishme pas më shumë se një ditë, foshnjën tuaj do ta kontrollojë një pediatër me eksperiencë i cili mund t'ju bëjë më shumë pyetje. Ata mund të organizojnë që foshnjës juaj t'i bëhet një skanim i zemrës.

Çfarë ndodh nëse foshnjës juaj duhet t'i bëhet një skanim?

Skanim me eko i zemrës së foshnjës tuaj, i quajtur ekokardiogram, mund të organizohet para se të largoheni nga spitali ose më vonë si një pacient i jashtëm. Ai tregon strukturën, funksionin dhe rrjedhjen e gjakut të zemrës për të parë nëse ekziston një problem nën të. Ky është një kontroll i drejtpërdrejtë, i ngjashëm me skanimet me eko të cilët kryehen gjatë shtatzënisë dhe nuk e dëmton foshnjën tuaj.

Foshnja juaj mund të ketë nevojë për trajtim, kontrolle të mëtejshme ose që të vazhdojë të ndiqet nga një mjek specialist për zemrën në rast se skanimi zbulon ndonjë anomali.

Çfarë duhet të kërkoj?

Shumica e foshnjave që kanë një fëshfërimë vazhdojnë të jenë mirë; megjithatë ju duhet të kërkonit këshilla nga mamia, vizitori shëndetësor ose GP [Mjeku i Përgjithshëm} në rast se foshnja juaj ka ndonjë nga këto:

- djersitje ose vështirësi në frymëmarrje, veçanërisht gjatë ushqyerjes
- duart, këmbët dhe buzët e kaltërta ose lëkura i bëhet me njolla (njolla të çrregullta me ngjyrë)
- lodhje ekstreme
- ënjtje e këmbëve, barkut ose rreth syve
- duket i/e zbehtë
- ushqim ose rritje e dobët.

Në rast se foshnja juaj duket se është seriozisht jo mirë telefononi numrin 999 ose shkoni në A&E.

A keni pyetje të tjera?

Nëse keni pyetje të tjera, ju lutemi të kontaktoni me sekretariatet pediatrike të Royal Free Hospital në numrin: 020 7830 2211. Një sekretare pediatrike do të organizojë që t'ju telefonojë një mjek.

Më shumë informacion

Për më shumë informacion rreth shërbimit neonatal në Royal Free London, ju lutem vizitoni faqen tonë të internetit: www.royalfree.nhs.uk/services/services-a-z/childrens-services/neonatal-units

Opinionet tuaja

Në rast se keni ndonjë opinion në lidhje me këtë fletëpalosje ose për një listë të referencave për të, ju lutemi dërgoni e-mail: rf.communications@nhs.net

Formate alternative

Kjo fletëpalosje është gjithashtu në dispozicion me shkronja të madha. Nëse keni nevojë për këtë fletëpalosje në një format tjetër – për shembull në Braille, një gjuhë tjetër përveç anglishtes ose audio – ju lutemi flisni me një anëtar të stafit.

© Royal Free London NHS Foundation Trust
Service: Neonatal
Version number: 2
Leaflet reference: RFL699SQ
Approval date: May 2023
Review date: May 2025
www.royalfree.nhs.uk